



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Punëve të Brendshme - Ministarstvo Unutrašnjih Poslova /

Ministry of Internal Affairs

Policia e Kosovës / Policia Kosova / Kosovo Police

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë /

Generalna Policijska Direkcija / General Police Directorate



RAPORTI VJETOR/ GODIŠNJI IZVEŠTAJ/ ANNUAL REPORT 2019





RAPORTI VJETOR 2019 ËSHTË HARTUAR NGA DREJTORIA PËR PLANIFIKIM STRATEGJIK DHE ÇËSHTJE LIGJORE - SEKTORI PËR PLANIFIKIM STRATEGJIK

Hartues të raportit janë:

Kolonel Isa HISENI

Shef i Sektorit për Planifikim strategjik

Major Sadik SHEFQETI dhe

Rreshter Fahrije LUTFIU

Puna gjatë hartimit të Raportit vjetor është mbikëqyrur dhe është koordinuar nga

Koloneli Reshat MALIQI

Drejtor i Drejtorisë për Planifikim Strategjik dhe Çështje Ligjore

Dizajni:

Çajup KAJTAZI

Lekturimi:

Leonora FEJZULLAHU - RUHANI

Përkthimi:

Sektori i përkthimeve

PËRMBAJTJA

2019

RAPORTI VJETOR I PUNËS I POLICISË SË KOSOVËS



MESAZHI I DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË POLICISË.....	4
PËRMBLEDHJE.....	5
SIGURIA, RENDI DHE QETËSIA PUBLIKE.....	7
PARANDALIMI DHE LUFTIMI I KRIMIT TË ORGANIZUAR, KRIMEVE TË RËNDA, KRIMIT EKONOMIK DHE KORRUPSIONIT, TERRORIZMIT, EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM DHE RADIKALIZMIT.....	11
KONTROLLI, MBIKËQYRJA DHE MENAXHIMI I INTEGRUAR I KUFIRIT SHTETËROR.....	14
NGRITJA E KAPACITETEVE NJERËZORE DHE MATERIALE.....	15
SHTOJCË.....	18
TABELA: VEPRA PENALE TË KARAKTERIT KUFITAR.....	21
TABELA: TË DHËNAT PËR RASTET E HAPURA, KLASIFIKIMI I KUNDËRVAJTJEVE:.....	23



z. Rashit QALAJ

DREJTOR I PËRGJITHSHËM I POLICISË
SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

MESAZHI I DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM PËR RAPORTIN VJETOR 2019

Policia e Kosovës si çdo fundvit nxjerr bilancin e punës një vjeçare, ku në bazë të statistikave, analizave dhe vlerësimeve, prezanton një tregues të qartë për nivelin e performancës së punës, të arriturat, por edhe sfidat me të cilat jemi ballafaquar gjatë vitit të fundit.

Duke u bazuar në të dhënat konkrete të raportit vjetor nga të gjitha departamentet dhe drejtoritë, lirisht mund të them se jemi të kënaqur, që në fund të kësaj periudhe kohore po shihen frytet e punës së palodhur të pjesëtarëve të Policisë së Kosovës. Aktivitetet e shtuara, sidomos në objektivat që kemi synuar për këtë vit, duke parë rezultatin e prekshëm pozitiv, na jep shpresë dhe na motivon edhe më shumë që të caktojmë edhe objektiva dhe prioritete tjera, të cilat do t'i arrijmë, pa dyshim.

Të arriturat dhe sukseset e Policisë janë me dobi shoqërore, sepse shërbimi ynë ndikon drejtpërdrejt edhe në jetën dhe veprimtaritë e të gjithë qytetarëve, pa dallim. Synim i çdo policie demokratike është krijimi i kushteve të sigurisë për qytetarët e vendit, në mënyrë që shoqëria të ketë zhvillim të gjithmbarshëm, duke mos lejuar cenimin e të drejtave të tyre në asnjë formë.

Referuar raportit vjetor, të dhënat konkrete na tregojnë se kemi pasur një rënie të konsiderueshme të rasteve në përgjithësi, si dhe rënie të veprave penale, gjithashtu.

Përpyekjet tona kanë qenë të fokusuara në të gjitha fushat në përgjegjësinë tonë institucionale, duke rritur intensitetin në luftimin e krimit të organizuar, krimeve ekonomike dhe korrupsionit, menaxhimin e kontrollit kufitar, luftimin e kontrabandës me mallra, si dhe sigurinë në trafikun rrugor.

Në të njëjtën kohë jemi angazhuar fuqishëm në ngritjen e kapaciteteve njerëzore, kapaciteteve teknologjike dhe infrastrukturore e gjithashtu duke qenë konsistent në fuqizimin e kontrollit të brendshëm dhe integritetit policor.

Si institucion me rëndësi të veçantë ne kemi vazhduar bashkëpunimin me institucione vendore dhe ato ndërkombëtare të paraprirra edhe përmes marrëveshjeve të lidhura ndër-institucionale që kemi lidhur gjatë vitit të fundit.

Bazuar në të gjitha aktivitetet e lartcekura dhe jo vetëm, Policia e Kosovës ka shënuar progres të theksuar gjatë këtij viti, me ç'rast vërehet në statistikën dhe të dhënat që na tregojnë raportin vjetor.

Dhe në fund, shpreh mirënjohjen time dhe vlerësimin e lartë për pjesëtarët e Policisë së Kosovës, të cilët me punën e tyre të palodhshme kanë bërë që organizata të gëzojë një besueshmëri dhe respekt të vazhdueshëm, andaj iu siguroj se do ta kenë mbështetjen e përzërvë, në mënyrë që të gjithë t'i u gëzohemi sukseseve të përbashkëta.

PËRMBLEDHJE



43668
Raste



30259
Vepra penale



4732
Persona
të ndaluar



13782
Persona të arrestuar



37
Grupe kriminale
të neutralizuara



1439
Armë zjarri
të konfiskuara



30438
Municione
të konfiskuara



113
Persona të vdekur në
trafikun rrugor



445776
Tiketa të shqiptuara
në trafikun rrugor



1005
Gjopa për kundërvajtjeve
në fushën e migrimit
dhe të huajve



16222
Aksidente në trafikun
rrugor



18145881
Hyrje/dalje të
personave në kufi



335
Protesta dhe tubime
të qytetarëve



3029
Refuzim të hyrjes
në RKS



940
Refuzim të daljes
nga RKS

Në Policinë e Kosovës janë të punësuar **9314** punonjës, prej të cilëve **8301** janë zyrtarë policorë, ndërsa **1013** staf civil. **84.95%** e personelit të Policisë i takojnë gjinisë mashkullore, ndërsa **15.05%** gjinisë femërore, prej të cilëve **84.57%** i takojnë përkatësisë etnike shqiptare, ndërsa **15.43%** i takojnë grupeve tjera etnike.

Policia e Kosovës, për vitin 2019, ka pasur në dispozicion buxhetin prej **106,018,614.80€**, i cili është realizuar në shkallë prej **98.76%**. Brenda kësaj periudhe ka arritur të ketë të hyra në shumë prej **13,191.399.84€**. Ka iniciuar **161** projekte të prokurimit dhe **755** urdhër blerje. Nga **161** projekte të iniciuara, janë nënshkruar **117** kontrata: **22** projekte kanë qenë me vlerë të lartë, **42** me vlerë të mesme, **58** me vlerë të vogël dhe **39** me vlerë minimale.

Policia e Kosovës ka organizuar **110** trajnime, ligjërata dhe punëtori për **3485** pjesëtarë të saj, **195** procese të ricertifikimit për **2707** pjesëtarë të Policisë. Në bashkëpunim me organizata tjera janë organizuar **340** trajnime për **4650** pjesëtarë të saj, ndërsa jashtë RKS-së janë organizuar **314** trajnime të cilat kanë vijuar **714** pjesëtarët të Policisë. Policia ka organizuar **6** trajnime për **139** pjesëmarrës nga organizata të ndryshme.

Si rezultat i këtij kontrolli të brendshëm gjatë këtij viti Drejtoria e Standardeve Profesionale (DSP) ka administruar **1573** lëndë disiplinore, ka hapur **846** lëndë të hapura në vitin raportues dhe **727** lëndë të bartura nga vitet paraprake. **855** lëndë janë përfunduar nga të cilat **256** lëndë kanë qenë me status të bazuar, **572** lëndë me status të pabazuar/të paargumentuar, **1** lëndë e rekomanduar në nivel lokal, **23** lëndë kanë pushuar hetimet dhe **3** lëndë janë kthyer në Inspektoratin Policor të Kosovës (IPK). Në Komisionin e Brendshëm Disiplinor (KBD) janë pranuar **1198** lëndë, janë shqyrtuar **1197** lëndë, në proces janë **145** lëndë. Nga gjithsej **1197** lëndë të trajtuara në KBD, janë marrë këto vendime: **26** raste të ndërprerjes së marrëdhënies së punës; **175** raste të ndalesës në pagë; **71** vërejtje me shkrim; **17** vërejtje me gojë; **30** raste lirim nga akuza; në **24** raste janë pushuar hetimet dhe **852** raste kanë qenë të paargumentuara dhe të pabazuara. Nga gjithsej **422** ankesa të shqyrtuara nga Komisioni i Ankesave (KA): **318** ankesa janë refuzuar, **32** ankesa janë aprovuar, **39** ankesa janë aprovuar pjesërisht, **23** lëndë janë kthyer për plotësim të hetimeve/rishqyrtim dhe rivendosje, **10** ankesa janë parashtruar jashtë afatit, tërhequr nga ankesa, i paautorizuar, nuk përmban arsyje, jo kompetencë.

Numri i rasteve të raportuara ka shënuar rënie për **8.90%**.

Numri i veprave penale ka shënuar rënie për **15.73%**.

Numri i personave të arrestuar ka shënuar rënie për **10.97%**.

Persona të vdekur në aksidentet e trafikut rrugor kanë shënuar rënie për **12.40%**.

Numri i aksidenteve në trafikun rrugor ka shënuar ngritje për **2.17%**.

Numri i tiketave të shqiptuara për kundërvajtje në trafik ka shënuar ngritje për **11.03%**.

Numri i refuzimeve të hyrjes në RKS ka shënuar ngritje për **50.02%**.

Numri i gjobave të shqiptuara për kundërvajtjeve në fushën e migrimit dhe të huajve ka shënuar rënie për **17.62%**.

Gjatë vitit 2019 në përputhje me Strategjinë e Policimit në Bashkësi dhe Planin e Veprimit 2018-2021, Policia ka vazhduar përkushtimin e saj në promovimin dhe ndërtimin e partneritetit me bashkësi, me qëllim të ngritjes së sigurisë në bashkësi me anë të bashkëpunimit dhe bashkërendimit të aktiviteteve me gjithë akterët të cilat mbulojnë fushën e sigurisë në bashkësi, të cilat do të jenë në gjendje që në mënyrë preventive të veprojnë në identifikimin dhe zgjidhjen e problemeve të cilat shkaktojnë shqetësimin dhe frikën e qytetarëve. Në kuadër të projektit të ngritjes së sigurisë nëpër shkolla, gjatë kësaj periudhe është zbatuar Urdhri Operativ (UO) "Stop drogave në shkolla", në bazë të të cilit janë realizuar **16030** patrullime parandaluese rreth shkollave, **7963** vizita dhe kontakte në shkolla, **91** ligjërata nëpër shkolla fillore dhe të mesme, për **5308** pjesëmarrës/nxënës, janë shpërndarë **3265** fletushka/broshura, **107** lokale të kontrolluara, **12946** automjete të kontrolluara, **19831** persona të kontrolluar, **227** persona të arrestuar, prej të cilëve **37** nxënës, ndërsa **190** të tjerë.

Zyra e Auditimit në kuadër të Policisë ka realizuar **12** auditime të rregullta dhe **2** të jashtëzakonshme, për të cilat janë dhënë **59** rekomandime. Njësia e Inspektimit e Policisë ka bërë **192** inspektime të rregullta si dhe **29** inspektime të jashtëzakonshme për të cilat janë dhënë **312** rekomandime.

Njësia Speciale Intervenuese ka qenë e angazhuar në **71** përcjellje për SHKK-në dhe **49** përcjellje sigurimi i granteve shtetërore (BKQ-së). Njësia Speciale Operative kanë qenë të angazhuara në **93** asistime SHKK-së, **798** asistime njësiteve tjera, **107** objekte të kontrolluara. IEDD ka realizuar **155** kontrollime të ndryshme në objekte, automjete dhe persona, ka intervenuar në **27** mjete të dyshuara shpërthyes, ka zhvilluar **16** hetime pas shpërthimit. Njësia K9 ka realizuar **636** kontrollime të ndryshme të personave, objekteve, veturave dhe hapësirave.

Me qëllim të ofrimit të sigurisë së kufijve, janë ndërmarrë: **151** operacione, **432** patrullime të përbashkëta, janë realizuar **127** raste të bashkëpunimit ndërkombëtar, **3029** refuzime të hyrjes dhe **940** refuzime të daljes nga RKS, shqiptuar **1005** gjoba në fushën e qëndrimit ilegal dhe mosvazhdimin e lejes së qëndrimit.

SIGURIA, RENDI DHE QETËSIA PUBLIKE

Në bashkëpunim të ngushtë me qytetarët, por edhe me të gjitha institucionet vendore dhe ndërkombëtare relevante në fushën e sigurisë, Policia ka arritur rezultate të konsiderueshme në luftimin e dukurive më shqetësuese të shoqërisë, përkundër sfidave të shumta të cilat janë paraqitur gjatë përmbushjeve të objektivave policore.

Gjatë vitit 2019, Policia ka evidentuar gjithsej 43668 raste. Prej tyre, 30259 janë klasifikuar si vepra penale, ndërsa 13409 si kundërvajtje dhe raste të natyrave tjera. Krahasuar me vitin 2018, numri i rasteve ka shënuar rënie për 8.90%, numri i veprave penale po ashtu ka shënuar rënie për 15.73%. Kurse numri i kundërvajtjeve dhe rastet e natyrave tjera ka shënuar ngritje për 11.45%.

Rënit më të dalluara pasqyrohen në vijim:

- Numri i vrasjeve ka shënuar rënie, nga 34 në 23 ose rënie për 32.35%;
- Numri i lëndimeve të rënda trupore ka shënuar rënie, nga 288 në 265, ose rënie për 7.98%;
- Numri i vjedhjeve ka shënuar rënie, nga 5842, në 4519, ose rënie për 22.64%;
- Numri i vjedhjeve të rënda ka shënuar rënie, nga 4774 në 3803, ose rënie për 20.33%;
- Numri i grabitjeve po ashtu ka shënuar rënie, nga 297 në 171, ose rënie për 42.42%.

Policia përkohësisht ka ndaluar 4732 persona, për shkak të dyshimeve në përfshirje në akte kriminale, ku në raport me vitin 2018 është shënuar ngritje për 11.84%. Po ashtu, Policia ka arrestuar 13782 persona, të cilët në bashkëpunim me autoritetet përkatëse, janë dërguar në procedura të mëtejme. Krahasuar me vitin 2018, vërehet një rënie e personave të arrestuar për 10.97%.



Në operacione të ndryshme të ndërmarra, Policia ka konfiskuar 1439 armë zjarri të llojeve të ndryshme, që në raport vitin 2018, është shënuar rënie për 2.10%. Po ashtu, ka konfiskuar 30438 copë municion të kalibrave të ndryshëm, që në raport me vitin 2018, është shënuar ngritje për 26.13%.

Gjatë vitit 2019, Policia ka menaxhuar gjithsej 335 protesta dhe tubime publike, në të cilat ka kryer një varg të detyrave policore lidhur me këto protesta dhe tubime. Në raport me vitin 2018, vërehet një ngritje e organizimit të protestave dhe tubimeve për 19.21%. Gjithashtu, gjatë vitit 2019 Policia ka ofruar 6531 asistime organeve, organizatave dhe agjencive të ndryshme.

Në fushën e aktiviteteve të Njësive Speciale Operative të Policisë, gjatë vitit 2019:

- Njësia Speciale Intervenuese ka qenë e angazhuar në 71 përcjellje për SHKK-në, 30 asistime divizioneve, drejtorive, DRP-ve dhe 49 përcjellje-sigurimi i granteve shtetërore (BKQ-së).
- Njësitë Speciale Operative kanë qenë të angazhuara në 93 asistime SHKK-së, 798 asistime njësive tjera, 107 objekte të kontrolluara, 76

persona të prangosur, armë të gjetura gjatë kontroleve gjithsej 91.

- Njësia për Trajtimin e Materieve Eksplozive (IEDD) ka realizuar 155 kontrollime të ndryshme në objekte, automjete dhe persona, ka intervenuar në 27 mjete të dyshuara shpërthyes, ka zhvilluar 16 hetime pas shpërthimit dhe 3 raste angazhime ndaj kërcënimeve me bombë;
- Ekipet policore me qen (K9) - kanë qenë të angazhuara në 169 asistime divizioneve, drejtorive, DRP-ve dhe ka realizuar 636 kontrollime të ndryshme të personave, objekteve, veturave dhe hapësirave;
- Njësia e Mbrojtjes së Afërt – ka qenë e angazhuar në 205 operacione dhe 34 ekstradime.

Gjatë muajit nëntor me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të PK-së, 265 operatorë nga Njësitë Speciale të Policisë, NJSO dhe NJRSH, janë angazhuar që të asistojnë Njësitë Speciale të Policisë në Shqipëri pas tërmetit të ndodhur në rajonin e qytetit të Durrësit. Operatorët nga Policia e Kosovës kanë qenë të angazhuar në ofrimin e ndihmës në menaxhim dhe udhëheqje të incidentit madhor me njësi speciale të Policisë, eprorë nga DNJS, si dhe nga drejtori i Përgjithshëm së bashku me drejtorin e Departamentit për Operacione. Gjithashtu i kanë asistuar Policisë Shqiptare

dhe agjencive tjera të sigurisë së Shqipërisë, së bashku me Forcën e Sigurisë të Kosovës dhe me ekspertë nga shtetet tjera pjesëmarrëse për kërkim shpëtimin e njerëzve pas tërmetit, sigurimin e vendit të ngjarjes ku ka ndodhur tërmeti, evakuimi i qytetarëve nga ndërtesat e goditura nga tërmeti, administrimi i situatës me qytetarët që kanë qenë të vendosur nëpër tenda, angazhim në të gjitha detyrat tjera që janë paraqitur në terren si rrjedhojë e situatës pas tërmetit dhe ofrimi i përkrahjes njerëzore për qytetarët e prekur nga tërmeti. Ky angazhim është kryer me nivel të lartë profesional duke luajtur rol me rëndësi në reagim, kërkim-shpëtim, parandalimin e përhapjes së panikut të qytetarët, evakuim dhe mbajtje të rendit dhe sigurisë në terren dhe menaxhim me sukses të plotë të të gjitha detyrave të pranuar.

Policia vazhdon të ofrojë siguri 24 orëshe, në 149 pika statike, të objekteve të rëndësisë së veçantë, si: diplomatike, qeveritare, policore, ministore, objekteve të trashëgimisë kulturore dhe fetare ortodokse. Ndërsa, për të gjitha objektet tjera të rëndësisë së veçantë, Policia kujdeset me anë të patrullimeve të rregullta, të cilat në bazë të vlerësimeve, ndërmerren edhe aktivitete tjera të nevojshme për sigurinë e këtyre objekteve.



Siguria në trafikun rrugor

Siguria në trafikun rrugor vazhdon të mbetet sfidëjovetëmpër Kosovën, por edhe për shumë shtete të Evropës dhe të botës. Për të adresuar këtë sfidë, Policia e Kosovës në vazhdimësi po bën përpjekje të mëdha që të rritet siguria në trafikun rrugor, duke përdorur një qasje të ofrimit të sigurisë e cila në thelb ka: a) parandalimin (me metodat proaktive dhe reaktive) dhe zbulimin e të gjitha aktiviteteve që mund të ndikojnë negativisht në sigurinë e përgjithshme të trafikun rrugor, b) bashkërendimin dhe koordinimin e veprimeve policore, me theks të veçantë ndërmjet njësive organizative të Policisë, pastaj ato ndërinstitucionale, ndërkombëtare, shoqërisë civile si dhe ekspertëve të ndryshëm të fushës së sigurisë në trafikun rrugor në kuptimin e saj më të gjerë, e cila në thelb të saj, gjithashtu ka edhe orientimin strategjik të adresimit të sfidave në trafikun rrugor.

Për të përmbushur detyrat nga lëmi i trafikut rrugor, Policia ka hartuar dhe ka zbatuar 8 plane operative në lidhje me ofrimin e sigurisë në trafikun rrugor. Policia, njëkohësisht ka zbatuar memorandumën e bashkëpunimit ndërmjet Policisë Shqiptare dhe Policisë së Kosovës, në fushën e ofrimit të sigurisë në trafik gjatë sezonit veror 2019.

Gjatë vitit 2019, Policia ka hartuar 127 raporte analitike, të cilat kanë qenë të orientuara në identifikimin dhe adresimin e dukurive negative në trafikun rrugor, duke përfshirë fenomenologjinë dhe etiologjinë e aksidenteve. Ka hartuar 88 raporte/shkresa në lidhje me gjendjen e infrastrukturës rrugore, të cilat janë adresuar te institucionet përkatëse. Janë realizuar 118 takime dhe pjesëmarrje në 48 emisione televizive, ka lëshuar 34 komunikata dhe ka hartuar 385 shkresa të ndryshme, të cilat kanë qenë të fokusuara në ngritjen e sigurisë në trafikun rrugor. Gjithashtu, Policia ka lansuar fushatat vetëdijesuese si: “Të gjithë jemi këmbësorë” dhe “Këshilla kryesore si të përgatitemi për ngasje gjatë dimrit”. Ndër-

sa, në bashkëpunim me Ministrinë e Industrisë dhe Transportit (MIT) ka hartuar fushatën “10 rregullat e arta të sigurisë”.

Gjithashtu, gjatë vitit 2019 është themeluar një Task forcë për lëvizjen e lirë të automjeteve dhe këmbësorëve në rrugët primare në kryeqytet, janë realizuar 719 përcjellje të materieve të rrezikshme, si dhe janë shqiptuar 445776 tiketa për kundërvajtje në trafikun rrugor, që krahasuar me vitin 2018, rezulton ngritje të shqiptimit të tiketave për 11.09%.

Komisioni për Vendosje gjatë këtij viti ka pranuar gjithsej 2589 kundërshtime (ankesa) nga të cilat 2526 i ka shqyrtuar si dhe ka mbajtur gjithsej 300 seanca.

Rëniët/ngritjet më të dalluara në vitin 2019 vërehen në:

- Aksidentet në trafikun rrugor, nga 15877 në 16222 aksidente, apo ngritje për 2.17 %;
- Aksidentet me dëme materiale, nga 9537 në 9974, apo ngritje për 4.58%;
- Aksidentet me pasoja fatale janë 100 sikurse në vitin 2018, nga ky numër i aksidenteve 113 persona kanë humbur jetën, që krahasuar me vitin 2018 shënon një rënie për 12.40%.
- Aksidentet me lëndime, nga 6240 në 6148, ose rënie për 1.47%. Nga ky numër i aksidenteve, 11860 persona janë lënduar, që krahasuar me vitin 2018 shënon rënie për 4.14%.



Policimi në Bashkësi

Me qëllim të ngritjes së sigurisë në bashkësi dhe në përputhje me Strategjinë e Policimit në Bashkësi dhe Planin e Veprimit 2018-2021, Policia e Kosovës ka vazhduar përkushtimin e saj në promovimin dhe ndërtimin e partneritetit me bashkësinë nëpërmes një sërë aktiviteteve të zhvilluara nëpër shkollë.

Gjatë vitit 2019, Policia ka realizuar një sërë projektesh dhe aktivitete të rëndësishme në fushën e parandalimit të krimit dhe realizimin e projekteve në vetëdijesimin dhe këshillimin e nxënësve në fusha të ndryshme të dukurive negative në shoqëri. Avancimi i Strategjisë së Policimit në Bashkësi dhe realizimi i aktiviteteve të parapara në këtë strategji, ka qenë ndër prioritetet e Drejtorisë së Policisë në Bashkësi dhe Preventivë, e në fokus të veçantë aktiviteteve që parashihen në objektivin “Për besueshmërinë dhe kënaqshmërinë e publikut me shërbimet e Policisë”.

Bashkëpunimi me partnerë të rëndësishëm si me Ministrinë e Punëve të Brendshme, forumet e sigurisë, OJQ, shkollat, prindërit, institucione fetare, OSBE, Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe mekanizma tjerë, ka ndikuar pozitivisht në arritjen e synimeve të parapara

për këtë vit. Avancimi i forumeve të sigurisë dhe realizimi i takimeve me këto forume, si dhe realizimi i projekteve të ndryshme nga anëtarët e KLSP-ve, ka dhënë rezultate të kënaqshme në parandalimin dhe krijimin e një ambienti më të qetë në të gjitha komunat ku edhe veprojnë.

Në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, drejtoritë komunale të arsimit dhe menaxhmentin e shkollave, në tërë institucionet e arsimit para-universitar të Republikës së Kosovës Policia ka organizuar aktivitete parandaluese dhe ligjëratave vetëdijesuese për nxënës në temat si: parandalimi i përdorimit të substancave narkotike, dhuna në familje, ngacmimet seksuale, parandalimi i ekstremizmit të dhunshëm që shpie në terrorizëm dhe dhuna në baza gjinore etj. Përveç ligjëratave dhe takimeve të drejtpërdrejta me nxënës, Policia e Kosovës ka shpërndarë edhe broshura me tema të ndryshme vetëdijesuese, siç janë: parandalimi i dhunës në mes të bashkëmoshatarëve, filozofia e policimit në bashkësi, parandalimi i pasojave nga përdorimi i substancave narkotike, ngritja e sigurisë në trafikun rrugor, parandalimi i keqpërdorimit të teknologjisë informative dhe rrjeteve sociale të komunikimit si dhe edukimi mbi rreziqet (rrugë, natyrë etj.), parandalimi i keqpërdorimit të fëmijëve (trafikimi me njerëz).



¹Strategjia e Policimit në Bashkësi dhe plani i veprimit 2017-2021 përbehet nga 4 objektiva, 12 nën objektiva dhe 55 aktiviteteve, të cilat konkretizojnë masat dhe veprimet të cilat duhet të ndërmerren për të përmbushur misionin dhe vizionin e kësaj strategjie. Objektivat kryesore të kësaj strategjie janë: (a) fuqizimi dhe avancimi i partneritetit, (b) ngritja e besueshmërisë dhe kënaqshmërisë së publikut me punën policore, (c) bashkërendimi i aktiviteteve të policimit në bashkësi me strategjitë tjera, si dhe (d) avancimi i reformave të brendshme dhe mekanizmat për monitorimin e zbatimit të strategjisë.

PARANDALIMI DHE LUFTIMI I KRIMIT TË ORGANIZUAR, KRIMEVE TË RËNDA, KRIMIT EKONOMIK DHE KORRUPSIONIT, TERRORIZMIT, EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM DHE RADIKALIZMIT

Gjatë vitit 2019 në kuadër të aktiviteteve policore të orientuara në parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar, krimeve të rënda, krimeve ekonomike dhe korrupsionit, terrorizmit, ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit, janë realizuar 1156 operacione, 1684 bastisje, si dhe janë kontrolluar 797 lokale.

Në vitin 2019 është punuar në gjithsej 2564 raste, prej tyre 1627 raste të reja, 736 raste të pranuar nga njësitë tjera në kuadër të Policisë së Kosovës, ndërsa 201 raste janë bartur nga vitet paraprake. Janë paraqitur 2122 kallëzime penale, 112 prej të cilave me kryes të panjohur, 2010 kallëzime penale, me kryes të njohur ndaj 3213 personave. Gjatë vitit 2019 janë arrestuar 2233 persona të dyshuar për vepra të rënda penale, si dhe janë neutralizuar 37 grupe kriminale.

Në fushën e luftimit të trafikimit me qenie njerëzore: gjatë vitit 2019 është punuar në 131 raste, janë realizuar 51 plane operative, 73 operacione, janë neutralizuar 3 grupe kriminale, janë arrestuar 205 persona të dyshuar, janë paraqitur 77 kallëzime penale, 24 raste janë dorëzuar në prokurori me raport të veçantë, 36 raste janë dorëzuar në gjykatë-Divizioni për Kundërvajtje, ndërsa për 17 raste vazhdojnë hetimet. Në vitin 2019 janë identifikuar 26 viktima të trafikimit dhe 13 viktima potenciale, 25 janë asistuar duke u strehuar në strehimoret përkatëse për riintegrim dhe rehabilitim, ku prej tyre 3 viktima janë riatdhesuar vullnetarisht në vendin e origjinës, ndërsa 22 viktima nuk e kanë pranuar programin e asistencës dhe strehimit por janë riintegruar drejtpërdrejt në familjet e tyre.

Në bashkëpunim me partnerët tjerë janë realizuar operacione për identifikimin e fëmijëve lëmshëkërkuesve, me qëllim të identifikimit të hershëm si viktima të mundshme të trafikimit.

Në realizim të këtyre planeve, janë intervistuar gjithsej 123 lëmshëkërkues (67 fëmijë në rrugë dhe 56 të rritur) si dhe janë paraqitur 22 kallëzime penale për veprën 'keqtrajtim apo braktisje e fëmijës'.

Në fushën e parandalimit, hetimit dhe zbulimit të trafikimit me narkotikë: gjithsej është punuar në 1450 raste, janë realizuar 1014 operacione, janë neutralizuar 15 grupe kriminale, janë hetuar 1768 persona të dyshuar, janë arrestuar 1625 persona, janë paraqitur 1363 kallëzime penale ndaj 1641 personave. Janë konfiskuar: 7 kg e 718 gr. heroinë; 1 kg 581.68 gr. kokainë; 824 kg. e 230gr. marihuanë, 25 kg e 447g hashash, 6810 copë bimë kanabis dhe substanca tjera narkotike.

Në kuadër të aktiviteteve të parandalimit dhe luftimit të drogave Policia ka zbatuar Urdhrin Operativ "Stop drogave në shkolla" në bazë të të cilit janë realizuar: 16030 patrullime parandaluese rreth shkollave, 7963 vizita dhe kontakte në shkolla, 91 ligjërata me nxënës për 5308 pjesëmarrës/nxënës, takime me prindër me 184 pjesëmarrës, 107 lokale të kontrolluara, 12946 automjete të kontrolluara, 19831 persona të kontrolluar, 227 persona të arrestuar, prej të cilëve 37 nxënës, ndërsa 190 të tjerë.



Gjithashtu, në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar, Policia e Kosovës/DHTN ka qenë partnere në projektin 'Cooperation South-east Danub Region- for combating drug trafficking' (Bashkëpunimi i vendeve të rajonit të Danubit jug-lindor). Projekti udhëhiqet nga BKA Gjermani dhe në kuadër të projektit është mbajtur një takim në Fyrth të Gjermanisë. Qëllimi i projektit është të diskutohet dhe të analizohet situata e shteteve të Danubit jug-lindor lidhur me trafikimin e narkotikëve dhe të prezantohen të arriturat në ueb faqen zyrtare të projektit, të cilët iu shërbejnë shteteve për parandalimin dhe luftimin e kësaj dukurie. Përveç shteteve anëtare, në projekt marrin pjesë edhe Interpol, Europol, UNODC dhe DEA. Përveç këtij projekti, zyrtarë nga DHTN kanë qenë pjesëmarrës edhe në aktivitete të tjera ndërkombëtare duke realizuar 6 takime operationale, 2 hetime dhe 3 operatione të përbashkëta.

Janë organizuar nga fondi global përmes CDF është mbajtur një konferencë në Edinbourg të Skocisë lidhur me reduktimin e dëmshkaktuar nga përdorimi i substancave narkotike.

Luftimi kundër krimeve ekonomike, korrupsionit dhe pasurisë

Në fushën e korrupsionit janë hetuar 169 raste, për krime ekonomike janë hetuar 199 raste dhe kundër pasurisë janë hetuar 261 raste, ndërsa vepra tjera penale që lidhen me fushën e ekonomisë dhe korrupsionit janë hetuar 25 raste fajde, 1 rast falsifikim/mashtim dhe 3 raste shpëlarje e parasë.

Gjithashtu, janë realizuar 32 operatione dhe 39 plane operative, si dhe janë neutralizuar 16 grupe të organizuara kriminale. Janë ngritur 541 kallëzime penale me kryes të njohur dhe 8 kallëzime penale kundër NN personave, ndërsa 67 raste janë përcjellë me raport të veçantë.

Si rezultat i angazhimit dhe zbatimit të ligjit për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së përfutur me vepër penale, gjatë vitit 2019 janë ngrirë, sekuestruar/konfiskuar

përkohësisht pasuritë në vijim:

- Asete të ngrira/sekuestruara janë: 4 shtëpi, 13 banesa, 8 parcela tokë, 7 lokale, 1 garazh, 22 vetura, 2,519,269.71€, 367.25\$, 570 CHF dhe prova tjera materiale.

Në fushën e hetimit të krimeve të rënda, gjatë vitit 2019 janë trajtuar 64 raste, prej të cilave 38 raste të reja, 19 raste janë pranuar nga njësi tjera, 7 janë trajtuar nga vitet e mëhershme. Janë realizuar 3 operatione, janë arrestuar 21 persona dhe janë paraqitur 67 kallëzime penale.

Parandalimi dhe luftimi i terrorizmit, ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit

Luftës kundër këtij fenomeni, Policia i është qasur në mënyrë strategjike, duke filluar prej bashkëpunimit në nivel lokal, nëpërmjet Këshillave Komunale për Siguri në Bashkësi (KKSB), Këshillave Lokale për Siguri në Bashkësi (KLSB), si dhe Strategjisë për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizmit që shpie në terrorizëm për periudhën 2015-2020, Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Joformale, Pastrimin e Parave, Financimin e Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2014-2019.



Gjatë këtij viti, autoritetet e specializuara për parandalimin dhe luftimin e terrorizmit në kuadër të Policisë së Kosovës kanë trajtuar gjithsej 86 raste, prej tyre 10 raste të reja. Kanë ndërmarrë gjithsej 3 operacione, 3 bastisje në rajone të ndryshme të Kosovës. Janë arrestuar 43 persona të dyshuar, janë paraqitur 14 kallëzime penale kundër 19 personave të dyshuar.

Ndër angazhimet dhe aktivitetet kryesore të Drejtorisë Kundër Terrorizmit gjatë vitit 2019 ka qenë procesi i kthimit të 110 qytetarëve të Republikës së Kosovës nga zona e konfliktit. Është bërë vlerësimi individual i rrezikshmërisë për secilin individ që gjendej në zonën e konfliktit, pastaj hartimin e listave me të dhëna të shtetasve të Republikës së Kosovës në zonën e konfliktit, si dhe hartimi i një dokumenti analitik, duke shtjelluar aspektet pozitive dhe ato negative, duke përfshirë edhe sfidat dhe kërcënimet në rast të kthimit apo moskthimit të qytetarëve të Republikës së Kosovës nga zona e konfliktit. Si pjesë e këtij procesi janë intervistuar 36 persona të dyshuar madhorë të kthyer (32 gra dhe 4 meshkuj), si dhe janë administruar të gjitha provat dhe dokumentet tjera të nevojshme për prokurorinë.

Në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar janë shkëmbyer gjithsej 595 informata, 14 takime op-



eracionale, 3 hetime të përbashkëta dhe janë realizuar 5 operacione të përbashkëta.

Po ashtu personeli i DKT-së ka marrë pjesë në mënyrë aktive në zbatimin e aktiviteteve që dalin nga Strategjia Nacionale Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizmit që shpie në Terrorizëm, duke veçuar aktivitetet për identifikimin e hershëm të personave të radikalizuar, si dhe pjesëmarrjen në debate dhe konferenca të ndryshme që kanë të bëjnë me radikalizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm.



KONTROLLI, MBIKËQYRJA DHE MENAXHIMI I INTEGRUAR I KUFIRIT SHTETËROR

Policia ka treguar një përkushtim të veçantë edhe në fushën e kontrollit dhe mbikëqyrjes së kufirit shtetëror, kontrollit të qëndrimit dhe lëvizjes së të huajve, luftimin e krimit ndërkufitar, si dhe avancimin e bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve përgjegjëse për Menaxhimin e IntegrUAR të Kufijve (MIK). Si rezultat i bashkëpunimit dhe bashkërendimit të aktiviteteve të autoriteteve të MIK-ut, kufijtë e Republikës së Kosovës i kanë kaluar: 18145881 persona, që krahasuar me vitin e kaluar ka ngritje për 2.13%; 5468043 mjete motorike, që tregon ngritje për 6.03% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, si dhe 1447 trena, që krahasuar me vitin e kaluar gjithashtu tregon rënie për 36.50%.

Në kuadër të kontrollit të hyrje-daljeve të personave në pikat kufitare, janë evidentuar dhe proceduar 5163 persona të rëndësishëm.

Sa i përket kontrollit të vijës së dytë, pjesëtarët e Policisë së Kosovës, në përputhje me parimet e MIK-ut, kanë arritur që të kontrollojnë, shih tabelën nr.1:

Kategoritë	Viti 2018	Viti 2019	%
Persona	78199	63764	18.45
Automjete	31167	29551	-5.18
Dokumente	17395	17838	2.54



Gjatë ofrimit të sigurisë së kufijve të Republikës së Kosovës, si rezultat i shkeljeve të ndryshme ligjore, pjesëtarët e Policisë së Kosovës kanë hapur 701 raste të veprave penale, 275 kundërvajtje, kanë shqiptuar 1005 gjopa në fushën e qëndrimit ilegal dhe mosvazhdimin e lejes së qëndrimit. Policia kufitare ka arrestuar: (a) 700 persona për vepra të ndryshme kriminale; (b) 1494 persona me urdhëresa vendore; (c) 7 persona me urdhëresa të ndryshme (ndërkombëtare etj.) dhe përkohësisht ka ndaluar 89 persona.

Me qëllim të përmbushjes së objektivave të parapara për vitin 2019, zyrtarët e Policisë Kufitare kanë bërë 1159 inspektime në fushën e migrimit të të huajve, 3029 refuzime të hyrjes, 940 refuzime të daljes, si dhe kanë realizuar 1396 verifikime të kërkesave për viza të Republikës së Kosovës. Po ashtu, zyrtarët e Policisë Kufitare kanë ekzekutuar 33 deportime dhe 110 urdhërlargime me forcë dhe kanë trajtuar 2079 kërkesa për azilkërkues.

Njëkohësisht, gjatë vitit 2019 janë bërë një numër i madh i konfiskimeve të ndryshme, ku ndër më të rëndësishmet kanë qenë konfiskimi i 23 armëve të zjarrit, 2 armë gazi; 3 pushkë ajrore; 761 municione të llojit të ndryshëm si dhe ka konfiskuar 98 vetura.

Policia Kufitare në vitin 2019 ka realizuar 151 operacione, 432 patrullime të përbashkëta me shtetet fqinje (Shqipëri, Maqedoni dhe Mali i Zi). Sa i përket menaxhimit të integruar të kufirit janë realizuar: 133 takime të punës në kuadër të Policisë, 205 takime me autoritetet e MIK-ut, ndërsa 127 aktivitete kanë qenë me karakter ndërkombëtar.



NGRITJA E KAPACITETEVE NJERËZORE DHE MATERIALE

Kapacitetet njerëzore

Aktualisht Policia e Kosovës ka 9314 punonjës, prej të cilëve 8301 janë zyrtarë policorë, ndërsa 1013 staf civil. Nga ky numër, 84.95% e personelit të Policisë i takojnë gjinisë mashkullore, ndërsa 15.05% gjinisë femërore, prej të cilëve 84.57% i takojnë përkatësisë etnike shqiptare, ndërsa 15.43% i takojnë grupeve tjera etnike.

Në këtë kontekst gjatë vitit 2019 në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike (AKSP) ka filluar dhe ka përfunduar trajnimin gjenerata e 54-të e Policisë me 429 kadetë policorë. Ndërsa, në trajnim gjendet gjenerata e 55-të me 433 kadetë policorë.

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e kontinuitetit të saj, Policia në vazhdimësi investon në kuadrat e saj, ofrimin e njohurive bashkëkohore në fushën e zbatimit të ligjit, ngritjen e sistemeve të bazës së të dhënave të nevojshme për kryerjen sa më efektive dhe efikase të punës policore, furnizimin me të gjitha pajisjet e nevojshme për kryerjen e detyrave policore, renovimi/sanimi dhe rregullimi i infrastrukturës së objekteve të PK-së, si dhe ngritja e shëndetit dhe mirëqenies së zyrtarëve të saj.

Si rezultat i një analize për nevojën e plotësimit të strukturës komanduese me stafin e ri, gjatë këtij viti janë graduar: 19 kolonelë, 13 nënkolonelë, 45 majorë, 59 kapitenë dhe 1 rreshter. Për angazhimin e dalluar të pjesëtarëve të Policisë janë dhënë: 273 medalje për shërbim të besnikërisë, 2 medalje për shërbim të dalluar, 2 medalje mburojë e Policisë, 11 medalje për lëvdim, 2 medalje policore për trimëri, 19 lëvdata dhe 13 mirënjohje. Brenda këtij viti janë shpallur 35 konkurse.

Një nga drejtimet e rëndësishme për rritjen e aftësive dhe kapaciteteve profesionale të Policisë ka qenë dhe mbetet prioritet trajnimi dhe shkollimi i punonjësve të Policisë. Gjatë vitit 2019, Policia e Kosovës ka organizuar 110



trajtime, ligjërata, punëtori për 3485 pjesëtarë të saj dhe 195 procese të ricertifikimit për 2707 pjesëtarë të Policisë. Në bashkëpunim me organizata tjera janë organizuar 340 trajtime për 4650 pjesëtarë të saj, ndërsa jashtë RKS-së janë organizuar 314 trajtime të cilat i kanë vijuar 714 pjesëtarë të Policisë. Duke marrë në konsideratë rëndësinë e qasjes së integruar të ofrimit të sigurisë në Republikën e Kosovës, gjatë këtij viti, Policia ka qenë e angazhuar edhe në ngritjen e kapaciteteve të organizatave tjera të RKS-së, duke i organizuar 6 trajtime për 139 pjesëmarrës nga organizata të ndryshme.

Shëndeti i personelit policor ka qenë në fokus të vazhdueshëm të organizatës. Me qëllim që të identifikohen, të adresohen dhe të parandalohen sëmundjet dhe rastet tjera psiko-emocionale në Policinë e Kosovës, gjatë vitit 2019 janë mbajtur:

- Ligjërata me temë “Parandalimi i vetëvrasjes”, ligjërata mbi indikatorët e hershëm të trafikimit, identifikimi fillestar dhe asistencë për viktimat TQNJ, ligjërata ‘Stresi në punë dhe komunikimi me njerëz të vështirë me 653 pjesëmarrës,

- Ligjërata me temë 'Stresi në punë dhe komunikimi me njerëz të vështirë' e mbajtur në stacionet policore të DRP Gjilan, DRP-Pejë, DRP Prizren, DRP Gjakovë, DRP-Kufiri Perëndimi dhe DRP-Kufiri Lindja,
- Fushata e dhënies vullnetare të gjakut për nevojat e Qendrës Kombëtare për Transfuzionin e Gjakut, në të cilin kanë marrë pjesë 1567 punonjës të Policisë,
- 155 seanca psikologjike,
- 227 seanca këshilluese,
- janë realizuar 128 vizita pjesëtarëve të Policisë nëpër spitale, si dhe
- 94 vizita në shtëpinë e tyre.

Kapacitetet materiale

Për të përmbushur të gjitha këto obligime me sukses, Policia për vitin 2019, ka pasur në dispozicion buxhetin prej 106,018,446.80€. Nga ky buxhet, për mallra dhe shërbime janë shfrytëzuar 13,455,856.00€, për shpenzime kapitale 13,952,597.27€, për shpenzime komunale 1,157,250.00, për subvencione dhe transfere 1,291,129.00€, për paga dhe mëditje 75,161,614.53€. Në përqindje buxheti është realizuar në shkallë prej 98.76%.

Gjatë këtij viti Policia ka realizuar të hyra në shumë prej 13,191,399.84€, që në krahasim me vitin e kaluar ka ngritje për 28.11%.

Policia ka iniciuar 161 projekte të prokurimit dhe 755 urdhër blerje. Prej 161 projekteve të prokurimit të iniciuara, janë nënshkruar 117 kontrata: 22 projekte ka qenë me vlerë të lartë, 42 me vlerë të mesme, 58 me vlerë të vogël dhe 39 me vlerë minimale. Ndërsa, nga gjithsej 755 urdhër blerje, 460 kanë qenë për furnizim, 275 për shërbim, ndërsa 20 për punë.

Policia rëndësi të veçantë i ka kushtuar zhvillimit dhe modernizimit të teknologjisë informative si dhe zgjerimit dhe mirëmbajtjes së sistemeve të komunikimit dhe menaxhimit të informacionit në përputhje me Planin Strategjik të Zhvillimit për 2018-2020. Në kuadër të Teknologjisë Infor-

mative dhe Komunikimit (TIK) janë vazhduar aktivitete të orientuara në ofrimin e qëndrueshmërisë në: Sistemin e Integruar Informativ të Policisë (SIPK), Sistemin e Integruar të Menaxhimit të Resurseve të Policisë (PRIMS), Sistemin e Menaxhimit të Kufijve (BIMS), sistemin e vëzhgimit përmes kamerave në objektet policore, rritjen e kapacitetit të rrjetit mikrovalor, Projekti 3D-GIS, mirëmbajtja dhe avancimi i SMSHA (Sistemi për Menaxhimin e Shpenzimeve të Automjeteve), projekt propozimi "Sistemi i Informacionit Gjeografik GIS për Policinë e Kosovës", digjitalizimi i radio-komunikimit-kalimi nga sistemi analog i radio komunikimit në digjital, zhvillimi i sistemit të ri të linjave emergjente 192, avancimi i sistemit telefonik VoIP.

Kontrolli i brendshëm

Për të siguruar një qasje profesionale në zbatim të ligjit, Policia monitoron, kontrollon dhe heton veprimet e zyrtarëve të saj. Si rezultat i këtij kontrolli të brendshëm gjatë këtij viti Drejtoria e Standardeve Profesionale (DSP) ka administruar 1573 lëndë disiplinore, ka hapur 846 lëndë në vitin raportues dhe 727 lëndë të bartura nga vitet paraprake. Gjatë këtij viti janë përfunduar 855 lëndë, nga të cilat 256 lëndë kanë qenë me status të bazuar, 572 lëndë me status të pabazuar/të paargumentuar, 1 lëndë është rekomanduar në nivel lokal, 23 lëndë kanë pushuar hetimet dhe 3 lëndë janë kthyer në IPK.

Në Komisionin e Brendshëm Disiplinor (KBD) janë pranuar 1198 lëndë nga Drejtoria e Hetimeve të Brendshme (DHB), janë shqyrtuar 1197 lëndë, si dhe në proces janë 145 lëndë. Nga gjithsej 1197 lëndë të trajtuara në KBD, janë marrë këto vendime: 26 raste të ndërprerjes së marrëdhënies së punës; 2 raste degradim; 175 raste të ndalesës në pagë; 71 vërejtje me shkrim; 17 vërejtje me gojë; 30 raste lirim nga akuza; në 24 raste janë pushuar hetimet dhe 852 raste kanë qenë të paargumentuara dhe pabazuara.

Nga gjithsej 422 ankesa të shqyrtuara nga Komisioni i Ankesave (KA): 318 ankesa janë refuzuar,

32 ankesa janë aprovuar, 39 ankesa janë aprovuar pjesërisht, 23 lëndë janë kthyer për plotësim të hetimeve/rishqyrtim dhe rivendosje, 10 ankesa janë parashtruar jashtë afatit, tërhequr nga ankesa, i paautorizuar, nuk përmban arsye, jo kompetencë.

Kontrolli i brendshëm i Policisë është fuqizuar edhe me auditimet dhe inspektimet e brendshme. Si rezultat i këtij kontrolli, gjatë vitit 2019, Zyra e Auditimit në kuadër të Policisë ka realizuar 12 auditime të rregullta dhe 2 auditime të jashtëzakonshme për të cilat janë dhënë 59 rekomandime. Këto auditime janë bërë në fusha të ndryshme të zbatimit të ligjeve dhe akteve nënligjore që lidhen me fushën e prokurimit, financave dhe menaxhimit të pasurisë, si dhe në fushën e zbatimit të procedurave administrative për personelin e Policisë.

Gjithashtu në kuadër të inspektimeve të brendshme Policia ka realizuar 192 inspektime të rregullta si dhe 29 inspektime të jashtëzakonshme në të gjitha fushat e inspektimit të punës së Policisë. Për të gjeturat e këtyre inspektimeve janë dhënë 312 rekomandime.

Aktivitetet tjera

Në vazhden e aktiviteteve të zhvillimit strategjik gjatë këtij viti janë rishikuar dhe janë plotësuar: UA nr.02/2019 për procedurën e gradimit për zyrtarët policorë, UA nr.04/2019 për shkeljet, masat dhe procedura disiplinore në Policinë e Kosovës, Rregullorja për Personel dhe Administratë në Policinë e Kosovës, Projektligji për pensionimin e zyrtarëve policorë dhe punonjësve të Inspektoratit Policor me autorizime policore. Janë nënshkruar 16 memorandume të mirëkuptimit, janë dhënë 7246 komente juridike për verifikimin e të kaluarës kriminale, si dhe janë dhënë 96 interpretime ligjore. Po ashtu është bërë rishikimi dhe vlerësimi i Planit Zhvillimor Strategjik të Policisë së Kosovës 2016-2020 dhe është përpiluar Plani Vjetor i Punës i Policisë së Kosovës për vitin 2020. Në vazhdimësi janë përpiluar raporte mujore, tremujore dhe vjetore të punës së Policisë.


Nga fushëveprimi i Zyrës së drejtorit të Përgjithshëm, janë nënshkruar 13 marrëveshje dhe memorandume të mirëkuptimit dhe bashkëpunimit në nivel vendor si dhe 10 marrëveshje dhe memorandume të mirëkuptimit dhe bashkëpunimit në nivel ndërkombëtar (UNMIK, EULEX, ICITAP, OSCE). Gjithashtu, sipas rekomandimeve të IPK-së, DSP-së dhe KBD-së, 93 zyrtarë policorë janë suspenduar përkohësisht dhe ndaj 47 zyrtarëve policorë është ndërprerë suspendimi.

Policia ka qenë vazhdimisht e përkushtuar në ngritjen dhe forcimin e bashkëpunimit me publikun, mediat elektronike dhe të shkruara, me qëllim të rritjes së transparencës për veprimet policore. Gjatë vitit 2019 janë realizuar 3280 përgjigje në kërkesa, janë publikuar 861 komunikata me shkrim për media, janë publikuar 365 raporte 24-orësh, si dhe në faqen e brendshme të Policisë - Intranet janë vendosur 15629 raporte të shpejta.


Gjatë këtij viti, personeli përkatës i ZIMP-it në nivel të DPP-së kanë bërë publikimin e statistikave 24 orëshe të kundërvajtjeve dhe aksidenteve të trafikut në ueb faqe dhe personeli përkatës i ZIMP-it në nivel DPP-së ka dizajnuar: mbi 77 projekte të ndryshme nga e gjithë Policia.




SHTOJCË




Grafikoni nr. 1 - Numri total i rasteve




Grafikoni nr. 2 - Numri i veprave penale




Grafikoni nr. 3 - Numri i personave të ndaluar




Grafikoni nr. 4 - Numri i personave të arrestuar




Grafikoni nr. 5 - Armë zjarri të konfiskuara




Grafikoni nr. 6 - Municione të konfiskuara




Grafikoni nr. 7 - Aksidente në trafikun rrugor




Grafikoni nr. 8 - Persona të vdekur në trafikun rrugor




Grafikoni nr. 9 - Numri i tiketave të shqiptuara për kundëroajtjeve në trafikun rrugor



Grafikoni nr. 10 - Hyrja/dalja të personave në kufi



Grafikoni nr. 11 - Numri i gjobave të shqiptuara për kundëroajtje në fushën e migrimit dhe të huajve



Grafikoni nr.12 - Kontrolli i vijës së dytë

TABELA: VEPRA PENALE TË KARAKTERIT KUFITAR

Nr.	Vepra penale	Viti 2018	Viti 2019	%
1	Kalim i paautorizuar i kufirit	189	90	-52
2	Kontrabandë me migrantë	16	17	6
3	Rastet me narkotikë	77	79	2
4	Kultivimi i narkotikëve, bimës së kanabisit	0	4	100
5	Kontrabandë me mallra	87	120	38
6	Shmangie nga tatimi	2	1	-50
7	Transportim ilegal i armëve	5	1	-80
8	Posedim i paligjshëm i armëve	60	38	-37
9	Falsifikim i dokumentit	83	67	-19
10	Falsifikim i automjeteve	1	0	-100
11	Falsifikim i parasë	0	2	100
12	Falsifikim i targave	1	1	0
13	Legalizim i përmbajtjes së pavërtetë	2	1	-50
14	Kontrabandë me kafshë	38	69	82
15	Dhënie e ryshfetit	10	5	-50
16	Vjedhje e pyllit	98	81	-17
17	Shkretimi i pyjeve	0	1	100
18	Tregti e ndaluar	10	14	40
19	Pengim i personit zyrtar në detyrë	5	5	0
20	Sulm ndaj personit zyrtar në detyrë	8	0	-100
21	Dëmtim prone (shpërdorim i pasurisë së huaj)	1	1	0
22	Vjedhje	10	5	-50
23	Kanosje	0	3	100
24	Kalim ilegal i kufirit dhe kontrabandë me mallra	0	43	100
25	Kontrabandë me dru	0	2	100
26	Tentim kalimi ilegal i kufirit	4	0	-100
27	Falsifikim i dokumentit dhe mashtrim	0	1	100
28	Arratisje e personit të privuar nga liria	0	1	100
29	Keqpërdorim i besimit	0	1	100
30	Shmangie nga taksat doganore	33	29	-12
31	Prezantim i rrejshëm si person zyrtar	2	1	-50
32	Lëndim i lehtë trupor	1	0	-100
33	Kalim i paautorizuar i kufirit, posedim i narkotikëve dhe posedim i armës	1	0	-100
34	Përvetësim në detyrë dhe veturë pa regjistrim	0	1	100
35	Gjueti e paligjshme	1	0	-100
36	Marrje e mitos	1	0	-100
37	Keqpërdorim i detyrës zyrtare dhe vjedhje e pyllit	1	0	-100
38	Kontrabandë me armë	2	0	-100
39	Transport ilegal i druve	1	0	-100
40	Vjedhje dhe keqpërdorim i dokumentit	1	0	-100
41	Kanosje, sulm, pengim dhe moszbatim i urdhrave të personit zyrtar	1	0	-100
42	Kontrabandë me migrantë dhe kalim ilegal i kufirit	0	1	100
43	Kontrabandë me mallra dhe shmangie e taksave doganore	0	1	100

44	Dhënie e ndihmës kryesve pas kryerjes së veprës penale	1	0	-100
45	Falsifikim i dokumentit dhe kontrabandë me migrantë	0	1	100
46	Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar	0	1	100
47	Kalim ilegal i kufirit dhe transport ilegal i druve	0	2	100
48	Nxitje e urrejtjes në baza fetare, racore dhe kombëtare	0	1	100
49	Vënie në qarkullim e mallrave me prejardhje të dyshimtë	1	0	-100
50	Posedim i paautorizuar i narkotikëve, armëve dhe kontrabandë me mallra	0	1	100
51	Vënie në qarkullim e prodhimeve ushqimore të dëmshme për shëndetin	0	2	100
52	Spiunazhi	0	1	100
53	Ushtrim i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore ose farmaceutike	0	1	100
54	Shmangie e taksave doganore dhe keqpërdorim i targave të automjetit	0	1	100
55	Fotografimi dhe incizimi i paautorizuar	0	1	100
56	Mosbindje e urdhrave të personit zyrtar	0	1	
57	Blerja, posedimi, shpërndarja, shitja e substancave narkotike, moszbatim i urdhrave të personit zyrtar dhe rrezikim i përgjithshëm i trafikut	0	1	100
58	Kalim ilegal i kufirit, shitja ose nxjerrja e të mirave natyrore, bimëve ose kafshëve posaçërisht të mbrojtura jashtë R. së Kosovës	0	1	100
TOTALI		754	701	-7

TABELA:
TË DHËNAT PËR RASTET E HAPURA, KLASIFIKIMI I KUNDËRVAJTJEVE:

Nr.	Kundërvajtjet	Viti 2018	Viti 2019	%
1	Keqpërdorim i dokumentit	28	35	25
2	Mosrespektim i urdhrave të personit zyrtar	14	12	-14.
3	Transportim ilegal i druve	143	133	-7
4	Mosrespektim i Ligjit për dokumente	5	1	-80
5	Transportim ilegal i kafshëve	14	40	186
6	Shmangie nga kontrolli policor dhe doganor	1	1	0
7	Transport ilegal i mallrave	1	0	-100
8	Shmangie nga tatimi	3	1	-67
9	Mosvazhdim i leje-qëndrimit	0	2	100
10	Përdorimi i targave të automjetit jostandarde	0	1	100
11	Shmangie nga obligimet doganore	27	20	-26
12	Mundësim i kryerjes së kontrollit kufitar	0	1	100
13	Posedim i dy pasaportave të vlefshme	1	0	-100
15	Mosdeklarim i mallit	0	1	100
16	Prishje e rendit dhe qetësisë publike	3	1	-67
17	Peshkim i kundërligjshëm	0	1	100
18	Vjedhje e pyllit	1	1	0
19	Mospërfillje e urdhrave të ligjshëm	2	0	-100
22	Sulm verbal	1	0	-100
23	Tregti e ndaluar	5	2	-60
24	Keqpërdorim i targave	1	3	200
26	Prerje ilegale e druve	1	0	-100
27	Dëmtim i pronës	1	0	-100
28	Qëndrim i paligjshëm	9	19	111
29	Ndotja dhe degradimi i ambientit	1	0	-100
	TOTALI	262	275	5

Kontakto / Contact / Kontakt POLICINË E KOSOVËS

Nga telefonja fikse dhe mobile / Od linije mobilni linije / From the fixed line By mobile:



Ju mund të dërgoni informatat e juaja edhe në adresën elektronike/ Takođe možete da pošaljete svoje podatke na e-mail adresu/ You can also send your information to the email address: info@kosovopolice.com

192 038 550 999

Të gjitha thirrjet në numrin **080019999** janë anonime, pa pagesë dhe konfidenciale
Svi pozivi su anonimni broj 080019999 , besplatan i poverljiv/ All calls are anonymous number 080019999, free and confidential